



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/52
Datë: 14.12.2011

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 dhjetor 2011, mori:

V E N D I M

1. Miratohet ekstrakti i procesverbalit dhe transkripti nga mbledhja e 49 e Qeverisë.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/52

Datë: 14.12.2011

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 dhjetor 2011, mori:

V E N D I M

1. Miratohet Projektligji për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/52
Datë: 14.12.2011

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 dhjetor 2011, mori:

V E N D I M

1. Miratohet Projektligji për Shërbimet e Shoqërisë Informatike.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:
- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/52
Datë: 14.12.2011

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 dhjetor 2011, mori:

V E N D I M

1. Miratohet Plani Zhvillimor Strategjik për Zyrën e Kryeministrit për vitin 2011-2014.
2. Obligohet Zyra e Kryeministrit për zbatimin e Strategjisë nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/52

Datë: 14.12.2011

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 dhjetor 2011, mori:

V E N D I M

1. Miratohet Plani Strategjik për Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik për vitin 2011-2014.
2. Obligohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik për zbatimin e Strategjisë nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/52
Datë: 14.12.2011

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 dhjetor 2011, mori:

V E N D I M

1. Miratohet Plani Strategjik për Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për vitin 2011-2014.
2. Obligohet Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për zbatimin e Strategjisë nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/52
Datë: 14.12.2011

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 dhjetor 2011, mori:

V E N D I M

1. Miratohet Udhëzimi Administrativ për Normat e Lejuara të Shkarkimeve në Ajër nga Burimet e Lëvizshme.
2. Obligohen të gjitha institucionet kompetente për zbatimin e Udhëzimit nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/52

Datë: 14.12.2011

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 dhjetor 2011, mori:

V E N D I M

1. Caktohet kompensimi për anëtarët e Bordit Drejtues të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë në shumën prej 100.00 (një qind euro në muaj) ndërsa Kryesuesit të Bordit Drejtues në shumën prej 150.00 (një qind e pesëdhjetë euro në muaj).
2. Pagesa të bëhet nga kodi buxhetor paga dhe mëditje, duke filluar nga data e konstituimit, në mënyre retroaktive.
3. Obligohet Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, Zyra për Buxhet dhe Financa për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/52

Datë: 14.12.2011

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 dhjetor 2011, mori:

V E N D I M

1. Caktohet kompensimi për anëtarët e Këshillit Shkencor të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë në shumën prej 100.00 (një qind Euro në muaj), ndërsa Koordinatorit të Këshillit Shkencor në shumën prej 150.00 (një qind e pesëdhjetë euro në muaj).
2. Pagesa të bëhet nga kodi buxhetor paga dhe mëditje, duke filluar nga data e konstituimit, në mënyre retroaktive.
3. Obligohet Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, Zyra për Buxhet dhe Financa për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/52

Datë: 14.12.2011

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 3 të Ligjit Nr. 03/L-241 për Prokurim Publik në Republikën e Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 dhjetor 2011, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Policisë së Republikës së Kosovës nr.689/dp/2011 dhe 718/dp/2011 për dhënien e pajtimit për Kërkesën e Policisë së Kosovës për blerjen e pajisjeve konfidenciale, në pajtim me nenin 3 të Ligjit për Prokurim Publik.
2. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme dhe Policia e Kosovës për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/52
Datë: 14.12.2011

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 dhjetor 2011, mori:

V E N D I M

1. Themelohet Bordi për Menaxhimin e Pyjeve në kuadër të kabinetit të Ministrit të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, për të zbatuar politikat, strategjitë dhe planet e veprimit të aprovuara nga Qeveria e Kosovës në këtë përbërje:
 - 1.1. Përfaqësues, Fakulteti i Shkencave Pyjore, Kryesues;
 - 1.2. Përfaqësues, Sekretar i Përgjithshëm i MBPZHR, anëtar;
 - 1.3. Përfaqësues, Sekretar i Përgjithshëm i MEF, anëtar;
 - 1.4. Përfaqësues, Sekretar i Përgjithshëm i MMPH, anëtar;
 - 1.5. Përfaqësues, Sekretar i Përgjithshëm i MASHT, anëtar;
 - 1.6. Përfaqësues, Kryetar i Asociacionit të Pyjeve Private, anëtar;
 - 1.7. Përfaqësues, Kryetar i Asociacionit të Komunave, anëtar.
2. Në rolin këshillëdhënës pa të drejtë vote, caktohen dy anëtarë nga komuniteti i donatorëve (një përfaqësues nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe një përfaqësues nga Bashkimi Evropian).
3. Bordi bën mbikëqyrjen dhe koordinimin e zbatimit të planeve operationale dhe Strategjisë së Pylltarisë, për vitin 2010-2020, si dhe aktiviteteteve tjera.
4. Kryesuesi drejton mbledhjet e Bordit për Menaxhim dhe përfaqëson atë i cili sipas rregullit takohet së paku katër (4) herë brenda vitit, duke ju përmbajtur agjendës së punës, si dhe merr vendim me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve.
5. Bordi për Menaxhim nga pika 1 e këtij vendimi, ka për detyrë të:

5.1 Mbikëqyr, koordinoj dhe t'i mbështes institucionet e ndërlidhura dhe të angazhuara në realizimin e aktiviteteve për zbatimin e politikave dhe strategjive të reja, sikurse edhe projektet e tjera zhvillimore të dalta nga to;

5.2 Siguroj që detyrat operacionale, apo zgjidhjet afatshkurtra, nuk janë në kundërshtim me politikat e miratuara dhe caqet zhvillimore në aspektin afatgjatë, dhe aty kur është e nevojshme të zbatohen masa përmirësuese;

5.3 Ofroj mbështetje institucionale me fokus në rritjen e kontributit të sektorit pyjor në ekonominë nacionale;

5.4 Ofrohet mbështetje teknike me këshilla për çështjet e lidhura me amandamentimin e legjislacionit dhe përmirësimin e bashkëpunimit mes nivelit qeveritar qendror dhe atij lokal;

5.5 Aprovoj (I) Planet Operacionale Vjetore të lidhura me menaxhimin dhe administrimin e tokave pyjore publike, dhe (II) të aprovoj investime kapitale që janë të lidhura me zbatimin e strategjisë dhe të planit të veprimit.

6. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe institucionet tjera relevante marrin të gjitha veprimet për administrimin e rregullt, ofrimin e përkrahjes dhe funksionimin e Bordit për Menaxhim me Pyje.
7. Obligohet Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për zbatimin e këtij vendimi.
8. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit, dhe shfuqizon vendimin nr.08/07 të datës 30.03.2011 .

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 12/52
Datë: 14.12.2011

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 dhjetor 2011, mori:

V E N D I M

1. Themelohet Komiteti Drejtues Ndërinstitucional për mbikëqyrjen dhe koordinimin e zbatimit të Planit të Veprimit për zbatimin e Strategjisë për Integrimin e Komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptas 2009-2015, në këtë përbërje:
 1. Radojica Tomic, Ministër për Kthim dhe Komunitete, Kryesues;
 2. Drejtori i Zyrës për Qeverisje të Mirë;
 3. Ramë Buja, Ministër i Arsimit, Shkencës dhe teknologjisë;
 4. Dardan Gashi, Ministër i Mjedisit dhe Planifikimit hapësinor;
 5. Ferid Agani, Ministër i Shëndetësisë;
 6. Drejtori i Zyrës për Çështje të Komunitetit, ZKM
 7. Një anëtar i Këshillit Konsultativ për Komunitete,
 8. Përfaqësues nga institucioni i Avokatit të Popullit,
 9. Një anëtar nga komuniteti rom,
 10. Një anëtar nga komuniteti ashkali dhe
 11. Një anëtar nga komuniteti egjiptian.
2. Komiteti Drejtues Ndërinstitucional do të kryej detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me Planin e Veprimit për zbatimin e Strategjisë për integrimin e Komiteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian 2009-2015, të miratuar nga Qeveria e Kosovës.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Zyra e Kryeministrit, ministrinë, institucionet tjera dhe anëtarët e komitetit.

4. Zyra për Qeverisje të Mirë në Zyrën e Kryeministrit shërben si sekretariat i Komitetit Drejtues Ndërinstitucional.
5. Me këtë vendim aprovohet përshkrimi i detyrave të punës dhe përgjegjësitë e komitetit drejtues, të bashkangjitura në shtojcën 1. dhe janë pjesë e këtij vendimi.
6. Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe shfuqizon vendimin Nr. 8/126 të datës 26.05.2010

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 13/52

Datë: 14.12.2011

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 dhjetor 2011, mori:

V E N D I M

1. Merret me qira objekti dhe hapësira e cila ndodhet në rrugën "Nazim Gafurri" nr.41, hapësirë kjo e cila në bazë të fletës poseduese dhe kopjes së planit është në shfrytëzim të Kishës Ortodokse Serbe.
2. Ky vendim dhe dokumentet që rrjedhin nga ai nuk paragjykojnë ndonjë të drejtë pronësore të asnjërës pale.
3. Për marrjen e këtij objekti lejohet anashkalim nga procedurat e prokurimit.
4. Mjetet për kompensimin e qerasë nga pika 1. e këtij vendimi sigurohen nga Ministria e Financave dhe planifikohen për vitin e ardhshëm në programin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.
5. Obligohet Ministria e Financave dhe Ministria Punës dhe Mirëqenies Sociale për zbatimin e këtij vendimi.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 14/52
Datë: 14.12.2011

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 11 dhe 45 të Ligjit Nr. 03/1 - 139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme, të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/ L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 dhjetor 2011, mori:

V E N D I M - P Ë R F U N D I M T A R

1. Miratohen shpronësimet në segmentin e pestë (5), për interes publik, të pronarëve dhe zotëruesve të interesit në pronat e paluajtshme, të cilat preken nga ndërtimi i Autostradës Vërmicë-Merdarë, në zonën kadastrale, Banjë, Lladrovç, Tërpezë, Carralugë, Shkarashnik, Balincë në Komunën e Malishevës, dhe zona kadastrale Arllat në Komunën e Drenasit, sipas tabelave të bashkangjitura këtij vendimi.
2. Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas nxjerrjes se këtij vendimi, Ministria e Financave, Kuvendi Komunal në territorin e se cilës kalon Autostrada në mbështetje të Ministrisë së Infrastrukturës i dërgojnë vendimin subjektit kërkues dhe personave tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1. të këtij vendimi.
3. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, Ministria për Financa në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës bënë shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh më të madh në Kosovë.
4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është akti i vlerësimit dhe tabelat në të cilat është e përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të të cilëve janë prekur nga procesi i shpronësimit.

5. Kundër këtij vendimi subjektet kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike në gjykatën kompetente, vetëm për kundërshtimin e shumës së kompensimit të përcaktuar në këtë vendim, subjekti kërkues, cilido person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i vendimit përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat e bashkangjitura të këtij vendimi.
6. Brenda dy (2) viteve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit, Ministria e Financave është e detyruar të paguaj plotësisht shumën e kompensimit të shpronësimit, të përcaktuar në këtë vendim.
7. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh më të madh në Kosovë.



Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë